


INVESTIMET STRATEGJIKE



invest in Albania





INVESTIMET STRATEGJIKE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES

SEKTORI "ENERGJETIK DHE MINERAR"



Investimi të jetë:

- i barabartë ose më i madh se 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar";
- i barabartë ose më i madh se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

SEKTORI "TRANSPORT, INFRASTRUKTURË E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE"



Investimi të jetë:

- i barabartë ose më i madh se 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar";
- i barabartë ose më i madh se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

SEKTORI "TURIZËM"



Investimi të jetë:

- i barabartë ose më i madh se 5 000 000 (pesë milionë) euro, dhe që krijon, minimalisht, 80 vende të reja pune, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar";
- i barabartë ose më i madh se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

SEKTORI "BUJQËSI DHE PESHKIM"



Investimi të jetë:

- i barabartë ose më i madh se 3 000 000 (tre milionë) euro, dhe që krijon, minimalisht, 50 vende të reja pune, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar";
- i barabartë ose më i madh se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

SEKTORI "ZONË E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK"



Investimi të jetë:

- i barabartë ose më i madh se 5 000 000 (pesë milionë) euro, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar";
- i barabartë ose më i madh se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

SEKTORI "ZONA ME PËRPARËSI ZHVILLIMI"



Investimi të jetë:

- i barabartë ose më i madh se 1 000 000 (një milionë) euro, dhe që krijon, minimalisht, 150 vende të reja pune, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar";
- i barabartë ose më i madh se 10 000 000 (dhjetë milionë) euro, dhe që krijon, minimalisht, 600 vende të reja pune, për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

Investime me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) Euro përfitojnë Statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", pasi të kenë marrë miratimin paraprak të ministrisë së linjës.

Investime me vlerë të barabartë ose më të madhe se 100 000 000 (njëqind milionë) Euro përfitojnë Statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

KUSH MUND TË APLIKOJË PËR TË PËRFITUAR STATUSIN "INVESTITOR/INVESTIM STRATEGJIK":

MINISTRIA E LINJËS

1

Ministria e linjës përgjegjëse për një projekt, për të përfituar statusin "Projekt me Potencial Strategjik"

INVESTITORI PROPOZUES I PROJEKTIT

2

Investitori propozues i projektit, për të përfituar statusin "Projekt me Potencial Strategjik"

SUBJEKTI INVESTUES

3

Subjekti investues propozues, për të përfituar statusin "Investitor/Investim Strategjik procedurë e asistuar", "Investitor/Investim Strategjik procedurë e veçantë"

PROCEDURAT E APLIKIMIT

1

Aplikimi tek AIDA nga ministrat e linjës përgjegjës për projektin.

Kërkesa duhet të shoqërohet me një relacion shpjegues mbi rëndësinë strategjike të projektit, si dhe përshkrimin e detajuar të elementëve të mëposhtëm:

- vlerën totale të parashikuar të investimit;
- kohën e nevojshme për realizimin e investimit;
- produktivitetin dhe vlerën e shtuar që do të sjellë investimi;
- mundësitë e punësimit dhe hapja e vendeve të reja të punës që parashikohen si pasojë e investimit;
- përputhshmërinë e projektit me politikat dhe prioritetet ekonomike sektoriale;
- mundësitë e zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal që paraqet investimi;
- mundësitë e zhvillimit dhe përmirësimit të kushteve e standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve që paraqet investimi;
- teknologjitë e reja që sjell investimi, të cilat rrisin konkurrencën dhe efektivitetin;
- rritjen e nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve si pasojë e realizimit të investimit;
- mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit që garanton projekti.

2

Aplikimi paraqitet nga investitori propozues i projektit.

Kërkesa shoqërohet me planin e biznesit të investimit, si dhe informacionin:

- identiteti i investitorit dhe i partnerëve të tij;
- përshkrimi i detajuar i projektit të investimit;
- përshkrim i detajuar i punëve që do të realizohen dhe shërbimeve që do të ofrohen sipas projektit investues;
- analizë e detajuar e afateve kohore që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e realizimit;
- përshkrimi i karakteristikave të investimit që i referohen specifiku të zhvillimit të teknologjive të reja dhe mbrojtjes së mjedisit;
- analizë financiare e të gjithë projektit investues si dhe analizë e shpenzimeve financiare që do të nevojiten për realizimin e çdo faze të projektit;
- analizë e detajuar mbi impaktin që punët dhe shërbimet e projektit mund të kenë mbi mjedisin dhe në planet urbanistike;
- analizë e detajuar e impaktit ekonomik dhe social të pritshëm nga realizimi i projektit investues;
- analizë e përfitimeve me interes publik që parashikohet të ketë shteti shqiptar nga realizimi i projektit;

3

Subjekti investues propozues, për të përfituar statusin "Investitor/Investim Strategjik procedurë e asistuar", "Investitor/Investim Strategjik procedurë e veçantë".

Aplikimi paraqitet nëpërmjet një kërkesë me shkrim së bashku me dokumentacionin përkatës:

1. përshkrim i identitetit të partnerëve
2. planin e biznesit;
3. planin e financimit;
4. programin e punës dhe afatet e parashikuara, të detajuara me fazat dhe veprimet përkatëse;
5. vlerësimin e ndikimit social, ekonomik dhe strategjik të projektit;
6. studim fisibiliteti;
7. përfitimet ekonomike, sociale dhe operacionale si edhe niveli i punësimit që parashikohen të realizohen;
8. listën me të gjitha masat, incentivat dhe shërbimet mbështetëse që subjekti investues kërkon nga shteti shqiptar për realizimin e projektit investues;
9. dokumentacionin që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues, si mënyrë garancie. Ky dokumentacion duhet të përmbajë të dhëna financiare, të cilat dëshmojnë në mënyrë bindëse dhe të qartë aftësinë e investitorit për realizimin e investimit, në masën jo më pak se 10 % të vlerës totale të investimit. Dokumentacioni që vërteton këtë kriter mund të jetë:
 - Bilance të tre viteve të fundit, ose
 - Financim dhe kreditim nga ana e institucioneve bankare ose financiare (vendase ose të huaja), ose
 - Garanci financiare lëshuar nga institute bankare ose financiare (vendase ose të huaja);
10. deklaratën e subjektit investues të interesuar me anë të së cilës subjekti merr përsipër dhe garanton vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura në dosje;

11. autorizimin me shkrim nga ana e investitorit, me të cilin autorizohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, për të kryer të gjitha verifikimet e nevojshme të të dhënave të paraqitura në dosje;

12. pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë, të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht nga subjekti i interesuar;

13. mandatpagesën për tarifat e aplikueshme;

14. Subjektet e interesuara, vërtetojnë njëkohësisht me anë të dokumentacionit përkatës faktin se subjekti:

- nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
- nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- kapitalet dhe asetet nuk janë objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm nga ana e shërbimit përmbarimor;

○ i ka përbushur rregullisht detyrimet në lidhje me pagesat e taksave dhe tatimeve;

○ i ka përbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

15. Subjekti përjashtohet nga përfitimi i statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale:

-Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, -organizatë kriminale; -bandë e armatosur; -organizatë terroriste; -korrupsion; -mashttrim; -pastrim parash ose financim i terrorizmit; -vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste; -organizim, -drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve; -falsifikim; -shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

PËRFITIMET


Procedurë e asistuar

- Kryerje e veprimeve përgatitore, përgatitje e dokumenteve dhe aplikim administrativ me procedurë të përsheptuar nga agjenti asistues;
- Trajtim me prioritet të përgatitjes së dokumentacionit, dhënies së mendimeve apo ndjekjen e procedurave, për përgatitjen dhe realizimin e investimit strategjik;
- Konsolidim i tokës;
- Programe mbështetëse;
- Mbështetje me infrastrukturë ndihmëse;
- Vënie në dispozicion të pasurive të paluajitshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, sipas legjislacionit në fuqi.

Procedurë e veçantë

- Shpronësimin e pasurive të paluajitshme, pronë private, për të mundësuar zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike;
- Miratimin nga ana e Kuvendit, kur vlerësohet nga Këshilli i Ministrave, të kontratave përkatëse të investimit strategjik, me kërkesë të investitorit strategjik për të rritur sigurinë e marrëdhënies juridike të rregulluar përmes tij dhe shtetit shqiptar.

INVESTIMET STRATEGJIKE HAP PAS HAPI





AIDA

ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



SKANO KËTU
për më tepër informacion

✉ info@aida.gov.al 🌐 aida.gov.al ☎ +355 (0)42 251 001 🐦 [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

📷 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida_albania) 📺 AIDA - Albanian Investment Development Agency